



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 6184/2 Prot.

B.Curri, më 31.12 2025

VENDIM

Nr. 78 datë 24.12.2025

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË PERFORMANCËS SË
BASHKISË TROPOJË PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 23, 24, 28 dhe 33 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 36 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018, Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor bazuar në buxhetimin sipas programeve dhe performancës, Udhëzimit nr. 22, datë 13.07.2018, “Për monitorimin e buxhetit në funksion të performancës financiare dhe rezultateve të arritura”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.04.2023 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin Vjetor të Performancës së Bashkisë Tropojë për vitin 2024, dokument zyrtar për vlerësimin e performancës institucionale dhe të shërbimeve publike vendore, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë Tropojë të nxjerrin detyrat përkatëse nga Raporti Vjetor i Performancës së Bashkisë Tropojë për vitin 2024 për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike vendore, planifikimin buxhetor dhe strategjik të bashkisë.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përgjegjëse për publikimin e Raportit, ndjekjen e rekomandimeve dhe raportimin periodik të masave të ndërmarra sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Shpallur me 30.12.2025, Miratuar me 11 vota, Vota Pro 11, Vota Kunder 0, Vota Abstenim 0

SEKRETARI
Ergent GJONGEÇAJ

KRYETARI
Arber ÇAKRAJ

